



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E DREJTËSISË

AGJENCIA E LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TE ZONAVE/NDERTIMEVE INFORMALE

DREJTORIA E ALUIZNI-t TIRANE RURALE

Nr./992/prot.

Tiranë, më 16.05.2018

## **NJOFTIM**

**PËR PROCEDURAT E LEGALIZIMIT TË "GODINË BANIMI DHE SHËRBIMESH 3 KAT ME 5 KAT ME NËNÇATI DHE 2 KAT PODRUM", NË EMËR TË SUBJEKTIT NDËRTUES "BESA G&T" SHPK.**

Pranë Drejtorisë së ALUIZNI-t Tiranë Rurale, janë administruar kërkesa nga qytetarët për legalizimin e njësive individuale, pasi kanë paraqitur kontrata të lidhura me shoqërinë ndërtuese "BESA G&T" SHPK. Në lidhje me procedurën e legalizimit të këtij ndërtimi, është njoftuar subjekti "BESA G&T" SHPK, për detyrimin ligjor të plotësimit të dokumentacionit të domosdoshëm sipas shkresës nr. 937 prot., datë 12.04.2017.

Në zbatim të pikës 1 gërma b) të VKM nr 19, datë 11.01.2017, "Për përcaktimin e rregullave të legalizimit të objekteve me leje ndërtimi, në të cilat janë kryer shtesa anësore ose në lartësi ose ndryshime të funksionit të hapësirave dhe të objekteve shumëkatëshe pa leje, të destinuara për kalimin e së drejtës së pronësisë apo qiradhënies", **subjekti i sipërcituar nuk ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar, për pasojë ky proces do të vijojë në favor të poseduesve të njësive individuale.**

Poseduesit e njësive individuale duhet të dorëzojnë **brenda 30 (tridhjetë) ditëve** nga data e këtij afishimi publik, dokumentacionin që provon marrëdhënien juridiko-civile me subjektin ndërtues "BESA G&T", SH.P.K.:

- Kontratë porosie dhe ose kontratë sipermarrje, (e noterizuar).
- Çertifikatë familjare të lëshuar për gjendjen familjare në datën e nënshkrimit të kontratës sipas pikës 1.
- Fotokopje kartë identiteti.
- Akt-ekspertizë e qëndrueshmërisë së objektit, i përgatitur nga një inxhinier konstruktor i liçensuar (ky dokument është i përbashkët për të gjithë banorët).

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

